



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 442 Akti

Nr. 549 Vendimi
Tiranë, më 8.7.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 8.7.2022, ora 12:00, në Tiranë, në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim çështjen që i përket,

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ilia Bano**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Aneksi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 1.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, komisionerit Olsi Komici, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, e ndryshuar”, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit Ilia Bano, i cili ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë deri në datën 14.6.2022, kur ka ndërruar jetë, ka qenë subjekt i rivlerësimit dhe iu nënshtrua rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, pas zhvillimit të procedurës së shpërndarjes me short të çështjeve në datën 16.12.2019, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Ilia Bano do t’i nënshtruhej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Olsi Komici dhe Xhensila Pine. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.
4. Me vendimin nr. ***, datë 8.1.2020, trupi gjykues deklaroi mosekzistencën e konfliktit të interesit, caktoi me mirëkuptim si kryesues komisioneren Valbona Sanxhaktari dhe vendosi fillimin e hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ilia Bano.
5. Referuar pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Ilia Bano nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ. Me e-mail-in e datës 9.1.2020, Komisioni i njoftoi subjektin të rivlerësimit përbërjen e trupit gjykues dhe pyetësorin standard, si dhe i kërkoi deklarin e konfliktit të interesit.
6. Komisioni zhvilloi hetimin administrativ, duke u bazuar në tri kriteret e vlerësimit, për qëllime të të cilit ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar; Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si dhe ka administruar të dhënat e nevojshme nga institucione të tjera.
7. Gjatë hetimit, Komisioni mori dijeni se subjekti i rivlerësimit Ilia Bano ka ndërruar jetë. Në këto kushte, Komisioni iu drejtua¹ Zyrës së Gjendjes Civile të Njesisë Administrative Nr. ***, të Bashkisë Tiranë, për të konfirmuar faktin e vdekjes së të ndjerit Ilia Bano.
8. Me shkresën nr. *** prot., datë 6.7.2022, Zyra e Gjendjes Civile të Njesisë Administrative Nr. ***, të Bashkisë Tiranë, i konfirmon Komisionit se shtetasi Ilia Bano ka ndërruar jetë në datën 14.6.2022, duke bashkëlidhur certifikatën e vdekjes së tij.

¹Shkresë nr. *** prot., datë 29.6.2022, e Komisionit.

ARSYETIMI I KOMISIONIT

9. Subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

10. Komisioni, pas fillimit të procedurës së rivlerësimit në kushtet kur subjekti ka ndërruar jetë, çmon se duhet të përfundojë këtë procedurë pa një vendim përfundimtar në bazë dhe për zbatim të pikës 3, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ku parashikohet: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij kodi*” dhe të nenit 93, ku parashikohet: “*Nëse pala, person fizik, vdes gjatë zhvillimit të procedurës administrative, që zhvillohet për një çështje të karakterit personal, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen*”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, bazuar në nenet 9 dhe 93 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 64 të ligjit nr. 94/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit, pa një vendim përfundimtar për subjektin Ilia Bano.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 8.7.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Xhensila PINE
Anëtare

Sekretare gjyqësor
Resilda Bilaj